



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Tel: 038/200 438 14

PROJEKT- RREGULLOREN KOMUNALE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA

P R O C E S V E R B A L

Nga diskutimi publik për projekt- Rregulloren Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba, mbajtur më: **15.12.2022**, në Sallën e Kuvendit të Komunës, filluar me punë në ora **10⁰⁰**.

Në Dëgjim ishin të pranishëm:

- | | |
|--|--|
| 1. <u>Genc Ademaj, Drejtor për
Ekonomi dhe Zhvillim;</u> | 3. <u>Elianë Blakaj, Drejtoresh për
Kulturë, Rini dhe Sport;</u> |
| 2. <u>Arben Kabashi, Drejtor për
Administrat Komunale;</u> | 4. <u>Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit</u> |

Diskutimi ishte i hapur për të gjithë qytetarët e pranishëm të cilët ishin ardhur për diskutimin e këtyre tri rregullorëve.

Diskutimin e hapi dhe e kryesoi, për projekt- Rregulloren Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim, z.Genc Ademaj.

Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim, z.Genc Ademaj.– përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje dhe hapi diskutimin publik për Rregulloren Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Njoftimi për Rregulloren Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba,
2. Propozimet e qytetarëve për draft-programin,
3. Pyetje dhe Përgjigje

Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim, z.Genc Ademaj, – Të nderuar qytetarë, po fillojmë me seancën e diskutimit publik me qytetarë në lidhje me draft- Rregulloren Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha, Kjo rregullore –përfshin të gjitha të gjithë qytetarët pa dallim, unë po e shfletoj para jush të gjithë draftin dhe pastaj vazhdojmë nëse ka ndonjë pyetje apo sugjerim. Tek kjo pjesa me të verdhë keni rekomandimet që janë dhënë nga drejtorët zyrtarët të cilët vazhdimisht ballafaqohen me kërkesa të qytetarëve këtë vit e kemi nga Ministria e punëve të brendshme një ndryshim tek ekstrakti, certifikata e lindjes te dokumentet e gjendjes civile i cili ka dal një udhëzim i ri për dokumentet që janë për brenda dhe jashtë vendit, tash dokumentet të cilat përdoren për jashtë vendit është aplikacioni e-Kosova të cilat janë online tash është rrit kostoja e tyre nga 1 euro si ka qenë është bërë 2 euro do të thotë ky është dallimi i certifikatës brenda dhe jashtë vendit që është edhe ngarkesë e re për qytetarët gjithashtu është edhe tek deklarata e bashkësisë familjare që është si vërtetim. Te drejtoria e urbanizimit mbrojtës dhe mjedisit është shtuar edhe një ngarkesë e re që nuk ka qenë më herët, leje për rrënimin e objekteve për metër katror është caktuar tarifa prej 1 euro për metër katror. Te drejtoria për Buxhet dhe Financa taksa për mjetet motorike për regjistrim të automjeteve respektivisht për automjetet me peshën deri ne 3.5 ton është rekomanduar që të ngritët tarifa nga 10 euro në 15 euro si dhe për automjetet mbi 3.5 ton është rekomanduar që të ngritët tarifa nga 20 euro në 30 euro te neni 6 të Drejtoria për Ekonomi dhe zhvillim unë si drejtor kam rekomanduar që taksa për lejin e pijeve alkoolike për hotele dhe motele të hiqet e cila ka qenë një ngarkesë vjetore për këto biznese gjithashtu ka qenë një ngarkesë tjetër taksa vjetore për lejin e pijeve alkoolike për kafiteri dhe restorante dhe lokale të ndryshme ka qenë një ngarkesë prej 20 euro dhe kam rekomanduar që këto dy ngarkesa të hiqen sepse edhe ligji e specifikon qartë ngarkesën e pijeve alkoolike që ka një normë tjetër tatimore krahasuar me produkte të ndryshme që përdoren në gastronomi. Te drejtorati i Arsimit neni 7 është rekomanduar pika 3.6 vërtetime të ndryshme të cilat kërkohen nga ish nxënësit e cila ka qenë 1 euro është rekomanduar që të jetë falas do të thotë të jetë pa ngarkesë te pika 3.7 për dëftesat e lëshuara nga kandidatët të cilët e kanë kryer shkollimin e obliguar sipas sistemit të vjetër të arsimit e të cilët shkaku i luftës i kanë humb vërtetimet e tyre e cila ka qenë 1 euro është rekomanduar që të bëhet 5 euro pasi që në udhëzimin e vjetër që ka qenë është bërë 5 euro pagesa mirëpo tash vetëm po e legjitimojmë atë kërkesë dhe atë ngarkesë e cila është shqiptuar në vazhdimësi. Te Drejtoria Për Kulturë, Rini dhe Sport nuk ka ndonjë ndryshim, mbetet e njëjtë ashtu siç ka qenë në fuqi. Te Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale neni 9 pika 1.1 vërtetim për lirim nga participimet është rekomanduar nga drejtorati që të hiqet, pika 1.3 pëlqim sanitar për licencim të ordinancave private edhe kjo hiqet pasi që ka kaluar në kompetencë rajonale tek inspektorati rajonal në Pejë i cili është centralizuar nga fillimi i vitit të kaluar, Raport për pëlqim sanitar, edhe kjo duhet të hiqet sepse nuk është më kompetencë e komunës ka kaluar edhe kjo në kompetencë rajonale te pika 1.6, certifikatë shëndetësore për regjistrimin e fëmijëve në çerdhe dhe kopshte ka qenë 10 euro është rekomanduar që të jetë falas, te certifikata shëndetësore për regjistrim në shkolla fillore të mesme të larta fakultete e nivele të tjera të shkollimit edhe këtu është rekomanduar që nga 10 euro të jetë falas edhe ky shërbim, të pjesa e shërbimeve në qendrën sociale te pika 5.5 për certifikata shëndetësore për edukim dhe shkollim është rekomanduar që të hiqet, te pika 5.6 është një ngarkesë shtesë që është kërkuar nga drejtoria që të shtohet vërtetim që nuk i është hequr zotësia e veprimt për armëmbajtje, kjo është një ngarkesë e re e cila është rekomanduar me shumën prej 20 euro, gjithashtu pika 5.7 është pikë e re vërtetim që nuk është

shfrytëzues i ndihmës sociale edhe kjo është e re dhe është në shumë prej 5 euro. Te drejtoria e shërbimeve publike mbrojtje dhe shpëtim nën 10 tek parkingjet publike shiritore e kemi ndryshuar tarifën pika 6.1 në parkingjet publike me shirita të ndarë në rrugë, trotuare tarifa për persona fizik është rekomanduar që nga 5 euro të jetë 30 euro për arsye që 5 euro tarifë shumë e ulët sepse vjen dikush e merr krejt shiritin e parkingut dhe zhvillon veprimtari biznesore dhe për atë është rekomanduar 30 euro që i bie 1 euro në ditë për persona juridik muajt ka qenë 10 euro për bankat posten etj. si për shembull këto që zhvillojnë aktivitetin para komunës ka qenë 10 euro është rekomanduar që të bëhet 50 euro. Te nën 11 Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi këtë pikën 1.1 e kemi shfuqizuar edhe në mbledhjen e fundit të Kuvendit, vlerësimi i dëmeve në Bujqësi ka qenë një ngarkesë prej 10 eurove do të thotë nëse një Bujk ka pasur dëme në Bujqësi ose Pylltari tash është me tarifën 0 tashmë është në fuqi sepse është shfuqizuar dhe është rekomanduar që të hiqet. Te pjesa 1.3 Taks për destinimin e tokës sipas klasave është udhëzimi administrativ 2006 kategoria 1 deri në 4 i kemi kategorizuar që më herët nuk kanë qenë kjo i referohet tokave që janë me tip të klasit bujqësor dhe ri-destinohen për leje ndërtimore ose ri-destinu për ndërtim, kategoria 1 deri në 4 për metër katror është planifikuar që të jetë 1 euro, kategoria 5 deri në 7 është rekomanduar që të jetë 0.75 cent për metër katror si dhe 7 deri në 8 është rekomanduar që të jetë 0.50 cent për metër katror, që më herët nuk kanë qenë e specifikuar. Këto janë rekomandimet që janë dhënë për plotësim ndryshim të kësaj rregullore për këtë vit. (vazhdon me shfletimin e draftit ku te pranishmit kishin mundësi ta shikonin nga projektori dhe me nga një kopje fizike për gjithsecilin)

Pren Palokaj (qytetar) – Faleminderit për fjalën, Unë nuk kisha dashtë me zgjatë shumë vetëm pata ta falënderoj drejtorin për këto sqarime dhe përgëzime për punën që jeni duke e bërë.

Pasi që nuk pati me pyetje nga qytetarët drejtori Ademaj mbylli punimet e diskutimit publik me qytetarë dhe falënderoj ata për kohën e tyre që kishin ardhur për këtë draft rregullore.

Faleminderit shumë!

Procesmbajtës:
Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave